

Vendim nr. 133 datë 20.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Sandër Beci, Anëtar
Marjana Semini, Anëtare

në datën 20.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (M) 2023 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: MARGENA ÇELA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-181, datë 31.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 42 dhe 43 të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Margena Çela është proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 5077/1 të vitit 2020, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i tretë, i Kodit Penal. Procedimi penal është bazuar në kallëzimin e datës 22.07.2020, sipas të cilit kërkuesja

në zyrën e saj noteriale ka falsifikuar nënshkrimin e një shtetasi në deklaratën noteriale të datës 03.05.2011, e cila është përdorur për qëllim legalizimi pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Korçë të një pasurie ndërtimore.

2. Në përfundim të hetimeve, prokuroria ka kërkuar dërgimin e çështjes penale në gjyq sipas akuzës. Paralelisht me këtë procedim, për të njëjtin fakt penal, ka regjistruar procedim penal edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, por në ngarkim të përdoruesit të dokumentit të falsifikuar, deklaratës noteriale.

3. Në seancën paraprake të datës 27.05.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorisë dhe kthimin e akteve asaj për plotësimin e hetimeve, me qëllim kryerjen e një akti të ri ekspertimi pranë Policisë Shkencore. Sipas gjykatës, hetimet duhet të përfundonin brenda datës 26.08.2021.

4. Me kërkesë të prokurorisë, në seancën paraprake të datës 16.09.2021, gjykata ka vendosur zgjatjen e afateve edhe me dy muaj të tjerë. Po në këtë seancë, gjykata ka marrë dijeni se për efekt të këtij procedimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit grafik-shkrimi nga 5 ekspertë dhe për ekonomi gjyqësore e moszvarritje të hetimit ka disponuar për administrimin e këtij akti pa qenë e nevojshme bërja e një riekspertimi, duke riorientuar prokurorinë për kryerjen e hetimeve.

5. Në vijim, në seancën paraprake të datës 03.12.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të kërkueses, me arsyetimin se fakti nuk përbën vepër penale. Sipas gjykatës, nga administrimi i aktit të ekspertimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të hartuar nga 5 ekspertë grafikë, ka rezultuar se shkrimi dhe nënshkrimi të rekuizitat përkatëse të deklaruesit në deklaratën noteriale të datës 03.05.2011, me noter kërkuesen, në të gjithë ekzemplarët objekt ekspertimi, janë të vetë kallëzuesit në cilësinë e deklaruesit. Po kështu, ajo ka vlerësuar se ka një tërësi provash që tregojnë dhe krijojnë bindjen e padiskutueshme se ka qenë vetë kallëzuesi që ka shkruar emër, mbiemër, nënshkrim, në cilësinë e deklaruesit në deklaratën e pretenduar si të falsifikuar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim prokurori dhe viktima/kallëzues.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 263, datë 23.03.2022, bazuar në nenin 332/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur ndryshimin e vendimit të datës 03.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e akteve prokurorisë pranë asaj gjykate, për plotësimin e hetimeve sipas urdhërimeve në pjesën arsyetuese të vendimit, duke i përcaktuar afat 90 ditë, nga momenti i marrjes së akteve. Gjykata ka arsyetuar se akti i ekspertimit i kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nuk plotëson kriteret ligjore për t'u konsideruar akt ekspertimi në kuadër të procedimit penal objekt gjykimi, si dhe nuk zëvendëson aktin e ekspertimit grafik-shkrimi që duhej të kryhej nga Prokuroria pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas gjykatës, bazuar në dispozitat procedurale, në asnjë rast nuk përcaktohet dhe nuk parashikohet se një akt ekspertimi i kryer në kuadër të një procedimi tjetër (qoftë edhe nëse ka lidhje midis fakteve dhe procedimeve), ka cilësinë e ekspertimit - si provë, në një procedim tjetër, por se ai mund të përdoret në cilësinë e dokumentit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuësja.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-181, datë 31.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk plotëson kushtet procedurale formale për t'u marrë në shqyrtim, pasi ndaj vendimit të seancës paraprake nuk parashikohet e drejta e ankimit, sepse shkeljet procedurale mund të rregullohen gjatë gjykimit të themelit. Sipas tij, vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për kthimin e akteve nuk është vendim që i jep fund seancës paraprake, por përcakton se veprimet hetimore nuk janë të plota dhe çështja nuk është gati për gjykim, prandaj e kthen atë në fazën e hetimeve paraprake. Po kështu, kjo gjykatë ka argumentuar se ligjvënësi nuk ka parashikuar të drejtë ankimi ndaj këtij vendimi, pasi kështu do të krijonte mundësinë e zhvillimit të hetimeve paralele, në ato raste kur prokurori zbaton vendimin e gjykatës për kthimin e akteve dhe kryerjen e veprimeve hetimore, ndërsa nga ana tjetër ndaj këtij vendimi ushtrohet ankim në gjykatat më të larta.

8. Në datën 26.04.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-181, datë 31.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuësjes

9. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspekt të:

9.1. *Së drejtës së aksesit në drejtësi*, pasi argumenti se rekursi është ushtruar ndaj një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet rekurs përbën një interpretim antikushtetues të ligjit procedural penal, duke krijuar praktikisht një normë të re, e cila i ndalon kërkuësjes të drejtën e ankimit/rekursit në atë gjykatë. Gjykata e Lartë ka ngatërruar/njësuar figurën e gjyqtarit të seancës paraprake me atë të gjyqtarit të apelit, e cila në çdo rast është një gjykatë rishikuese. Për më tepër, gjykata e apelit ka disponuar përtej kërtimeve të ankuesve, të cilët nuk kanë kërkuar kthimin e akteve prokurorisë dhe vijimin e hetimeve.

9.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi ai nuk përmbush kërkesën për qartësi, është pjesërisht kontradiktor dhe i mungon arsytimi në një pjesë të tij. Për shkak të këtij arsytimi, Gjykata e Lartë ka cenuar edhe *parimin e sigurisë juridike*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitetit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Kolegji vlerëson se kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor penal - në cilësinë e të pandehurës - në të cilin është dhënë vendimi i Gjykatës së Lartë i kundërshtuar prej saj, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuësi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

14. Shterimi i mjeteve juridike efektive nënkupton që kërkuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 56, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesja ka kundërshtuar vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, e cila nuk ka pranuar rekursin kundër vendimit të gjykatës së apelit që i ka kthyer aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për plotësimin e hetimeve. Sipas kërkueses, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës për proces të rregullt ligjor (*në aspekt të së drejtës së aksesit, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike*), të garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Në kontekst të rrethanave të faktit, Kolegji evidenton se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës, vendimi nr. 00-2023-181, datë 31.01.2023 i Gjykatës së Lartë nuk ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të kërkueses për efekt të gjykimit kushtetues, për sa kohë që ajo ende nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhur me akuzën e ngritur ndaj saj. Kjo do të thotë se kërkuesja ka ende mjete juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese pranë atyre gjykatave, përfshi më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

17. Në përfundim, Kolegji vlerëson se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.